



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 03/2018

Datë: 31. 01.2018. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i ueb faqes së re të KQZ-së;*

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2017;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimeve për vitin 2017;*

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

Valdete Daka: Përshëndetje. I kemi pikat e rendit e ditës, mirëpo kam propozim që pikën e raportit financiar ta shtyjme për mbledhjen e ardhshme sepse, krye shefi nuk është prezent dhe ne, sigurisht që kemi edhe pyetje për te. Prandaj, propozojmë që ta shtyjme...

Ilir Gashi: Kryetare, nuk kemi afat për ta shty këtë pikë të rendit të ditës...

Valdete Daka: Nuk ka afat...? Pse na e keni sjellë në rend të ditës kur e keni ditur që nuk ka afat!

Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it: Nuk varet raporti financiar nga ne se kur e realizojmë, sepse ne jemi të varur në barazim me Thesarin. Kam pranuar edhe dje kthime, e të cilat nuk janë të inkorporueme në raportin final të thesarit. Raporti është deri më 31 janar për ta dorëzuar. Ne kemi pritur barazimet. Unë kam komunikuar me thesarin, dhe ata na kanë thënë dorëzoni ashtu si i keni bërë...! Nëse nuk e dorëzojmë, ne marrim vërejtje si KQZ. Unë, siç i kam në raport që e keni para vetës, unë jam e gatshme të raportojoj...

Valde Daka: Raporti ka shumë specifika, dhe krye shefi duhet të jetë këtu në mbledhje...! Dhe po më duket jo përgjegjësi e tij mos me qenë prezentë, sepse edhe e ka ditur që raporti duhet të shkoj...Ok, meqë duhet të dorëzohet...! Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e parë: miratimi i procesverbalit 02/2018. A ka ndokush vërejtje? Nëse jo, kush është për miratim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin 02/ 2018 nga mbledhja e KQZ-së (me një abstenim: znj. Vldete Daka).

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve

Adnan Rrustemi: Me kërkesë të kryesues të këshillit ju njoftoj se, në mbledhjen e fundit të mbajtur të këshillit kemi shqyrtuar kërkesat e kryesuesve të kuvendeve komunale, dhe unë po i lexoj rastet konkrete:

Në komunën e Zubin Potokut, emërohet anëtar i kuvendit komunal Zenel Jakupi, dhe i njëjti, e zëvendëson Agim Hasanin nga subjekti politik LDK,

Në komunën e Podujevës, emërohet anëtar i kuvendit komunal Benjamin Ejupi, Jakupi, dhe i njëjti, e zëvendëson Esat Ejupin nga subjekti politik Partia e Drejtësisë,

Në komunën e Prizrenit, emërohet anëtar i kuvendit komunal Karanfil Haxhillari, dhe i njëjti, e zëvendëson Faruk Dakajn nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!,

Në komunën e Prizrenit, emërohet anëtar i kuvendit komunal Edis Alili, dhe i njëjti, e zëvendëson Bedrija Ejupagiqin nga VAKAT,

Në komunën e Prishtinës, emërohet anëtar i kuvendit komunal Bashkim Beha, dhe i njëjti, e zëvendëson Yll Rugovën,

Në komunën e Mamushes, emërohet anëtar i kuvendit komunal Nehat Thaçi, dhe i njëjti, e zëvendëson Hilmi Salen,

Në komunën e Gjilanit, mërohet anëtar i kuvendit komunal Burim Berisha, dhe i njëjti, e zëvendëson Bardhyl Sylen nga subjekti politik LDK.

Valdete Daka: A i votojmë në pako, meqë u lexuan tashmë...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan në pako këto zëvendësime me vota unanime.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2017

Ilir Gashi: Ne, si këshill kemi trajtuar dy pikat e rendit të ditës që i keni para vetës! Sa i përket pikës së parë, ne kemi bërë shqyrtimet dhe kemi dhënë edhe vërejtjet...Prandaj, ju këtë raport e keni para vetës dhe, ne rekomandojmë që ky raport të miratohet nga KQZ.

P.s. Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it, tha se hartimi dhe miratimi i raportit financiar praktikohet me ligj dhe në bazë të procedurave, janë përgatitur edhe pasqyrat financiare. Ajo, i bëri një rezymë të gjatë këtij raporti duke dhënë shpjegime dhe, analiza të nevojshme – të

hollësishme. Në fund të paraqitjes së rezymësë së znj. Meha, bënë diskutime dhe analiza edhe anëtarët e KQZ-së:

Betim Gjoshi: E para, ne si KQZ nuk jemi duke bërë mbikëqyrje të duhur të buxhetit dhe shpenzimeve, por kjo ndodh edhe për shkak të dinamikës por edhe dy proceseve zgjedhore. E dyta, nga jashtë institucionit tonë janë disa gjëra që bien në sy! Për shembull, shpenzimet e telefonisë mobile 66 000 euro (fa. 10 jam duke iu referuar), shpenzimet postare mbi 100 000 euro, furnizim për zyre 1 milion e 84 000 euro, shpenzim për derivate të veturave 18 330 euro, riparim të veturave mbi 11 000 euro, dreka zyrtare 28 000 euro, shërbime kontraktuale 8 milion e mbi 800 0000 euro etj. Unë, personalisht e di që në raport të shpenzimeve pasqyrohen njëra mbas tjetrës, por për disa edhe në pasqyrat financiare ka qenë mirë me dhënë shpjegime, sidomos të shërbimit kontraktuale! Sepse, duhet qartësuar çështjet. Kur shihet nga jashtë, kjo duket skandal! Në anën tjetër, fq. 23 ka disa gjëra që për mua janë shqetësuese, për shembull: ishte një kontest 162 000 euro të fondi i partive politike që, i ka kaluar të gjitha fazat gjyqësore dhe është mbyllë ky rast, e kam fjalën nëse flitet për kontestin LB – LVV! Çka kemi na me pague, unë nuk e di...? Po ashtu, një pagesë për auditorin e brendshëm 1131 euro s’e di pse duhet me e pague për dy muaj...!

Për informimin publik, edhe pse e di që kemi kontest, nuk e di se cka ka vendosur gjykata. Për ju, ndoshta duket e rëndësishme por, pse janë futur këtu unë s’po e kuptoj. Ka çështje të tjera që, sigurisht duhet përballuar, si për shembull tejkalimet e bëra. Ne, e kemi lejuar një hapësirë gjatë zgjedhjeve për stafin jo permanent, mirëpo ne kemi paguar 5 milion euro dhe, ky është masakrim i buxhetit të vendit! Pra, janë bërë tejkalime të mëdha të pranimit të stafit jo permanent.

Unë, po të isha në vend të Sekretariatit, isha frikësuar ! Me këtë raport, ne as nuk ju amnistojmë dhe as nuk ju dënojmë! Por, është zor të mbrohet ky raport. Edhe unë, jam vetëkritik sepse, kemi bërë lëshime. Por, kjo është e tepruar! Bile, pa e llogaritur “400” – mijëshin e buxhetit të shpenzuar që, nuk ka kaluar kah ne, kah anëtarët e KQZ. E shprehi qëndrimin për miratim të raportit, por jo pa e audituar raportin....! Kërkoj që të dimë se, a duhet t’i paguajmë këto të gjitha...

Valdete Daka: Këto tri të parat, ekziston mundësia që edhe nuk duhet me i paguar, sepse janë konteste në zhvillim e sipër. Pastaj, edhe kjo e fondit të partive, këtu thuhet se nuk ka përfundue...! Lënda ka shkuar me ankesë në Gjykatën e Apelit...! Gjykata themelore në Prishtinë..., ende ekziston mundësia që duhet me pagua...

Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it: Faqja 23: Janë dy lloj burime që unë i kam marrë, e para, tri të parat janë marrë prej Zyrës Ligjore që janë me përmbarues. Pjesa tjetër janë që, kanë ardhur faktuarat për tejkalim të kontratave që edhe janë të pranuar nga zyrtarët e Sekretariatit. Ky, është obligim që duhet deklaruar, janë detyrime kontigjente.

Valdete Daka: Këto që janë me përmbarim, kemi me i paguar patjetër, plus kemi me i paguar shpenzimet e përmbaruesit, plus kamatat...! Unë, s'po kuptoj pse po bani prapësimet kur, ju mallin e keni marrë...! Pra, malli është pranuar. Kot bëhet prapësimi, sepse ti vetë e ke porositur këtë mall, dhe përderisa është sjellë malli dhe është pranuar, është nënshkruar pranimi...! Prapësimi, vetëm e shtynë përmbarimin, kurse ne detyrohemi me i paguar kamatat ekstra. Kemi me u detyrua me i paguar kamatat mbi këto shuma! Për shembull, për shumën prej 40 000 euro kemi m'u detyrua me pagua kamatë, edhe atë në mjetet e afatizuara prej 8% që është në këtë vit.

Çdo ditë, tha znj. Daka, për ne është duke ecur kamata! Edhe ky "400 mijëshi", nuk ka me na e mbuluar, ka me u bë "500 – mijë"! Prapësimi dërgohet në gjykatë. Gjykata vendosë...! Pra, del që njësitë kërkuese nuk kanë ditë me i bërë specifikat...

Miradije Meha: Unë, duhet t'i paraqesë në raport si janë...!

Adnan Rrustemi: Raporti, e prezanton gjendjen reale. Për krejt rastet ku bëhet fjalë për tejkalim kontrate, na duhet një analizë më e thelluar se për çfarë tejkalimi bëhet fjalë! Mbase, edhe auditori i brendshëm duhet të përfshihet. Pra, duhet të bëhet auditim i këtyre kontratave. Nëse bëhet fjalë për tejkalim në sasi, ne ishte dashur me i pas kontratat që vazhdimisht i kemi shtyrë përpara që, me u dhënë çmimi për njësi por asnjëherë mos me u përcaktuar sasia strikte sepse, sasinë nuk mund ta përcaktojmë striktë në specifika! Për shembull, ne kërkojmë 200 mijë fletëvotime dhe ajo mund të rritet, por gjithëherë na duhet çmimi për njësi...! Unë, tha z. Rrustemi, kam nevojë për shpjegime. Këtu, sic po e shohë është tejkalimi i parë për Paket e Trajnimit 11 000 euro, tjetra është 19 000 material për Paket e Vendvotimeve, 25 000 euro është tejkalim për Sprej, 41 është për Material Zgjedhor, 25 000 euro është për Benxha, 11 000 është për Llamba, 4 000 të tjera janë për Sprej, dhe 6000 mijë është e fundit, pra pjesa dërmuese është tejkalim...! Pra, a bëhet fjalë për tejkalime të gabuara e që janë anuluar, ne nuk e dimë si anëtarë të KQZ-së...Pra, a janë bërë gabime, apo...?

Valdete Daka: Unë, po them diçka: çdo tejkalim mbi 30%, është vepër penale, vepër penale...! Këto detyrime kontingjente, ne do të na rrezikojnë shumë...! Kemi me paguar edhe kamatë...! Pastaj, edhe shpenzimet gjyqësore...!

Eshref Vishi: Është fakt se forma dhe mënyra e organizimit në KQZ, në një farë forme na obligon që të kemi “besim” në parim. Ky besim, është tek administrata, tek zyrtarët profesional që zhvillojnë aktivitete dhe përmbushin planin e punës brenda KQZ-së. Format e kontrollit, janë mekanizmat ligjor që administrata duhet t’i zbatojë dhe mbi bazën e kontrolleve na jepen pasqyrime të sakta lidhur me mbarëvajtjen procesit të punës brenda KQZ-së. Për mua, është shqetësues në tre – katër aspekte ky raport: 1. Detyrimet e papaguara në shumë totale prej 144 000 euro, dhe që këto barten nga viti 2017 në vitin 2018. Është evidente se detyrimet mund të mos kryhen përgjatë viti fiskal, dhe ato barten në vitin tjetër por, kanë mundur të zhvillohen procedura të sakta që prej kontraktiveve e deri te përfundimi i pagesave por ka pasur neglizhime gjithandej, sado që e kuptoj dinamikën... 2. Detyrimet kontingjente, diku rreth 400 000 euro, saktësisht 400 6000 euro..! 3. Problem tjetër është tejkalimi i kontratave për aktivitetet prokuruese për dy proceset zgjedhore.

Raportimet në shifra shpenzuese prej 10 milion e 600 000 euro, është standard raportues i kërkuar nga MEF, dhe mbi këtë bazë është bërë edhe raportimi i drejtoreshës. Mirëpo, tek tejkalimet kontraktuale, mbetet të shihet se si janë shpenzuar mjetet. Se sa janë zhvilluar procedurat në përputhje me ligjin, këtë mbetet ta tregojë raporti i auditimit: edhe raporti i auditimit të jashtëm, edhe raporti i auditimit të brendshëm.

Këto pasqyra, janë publike dhe nuk ka mundësi të mistifikohet asgjë!

Sylejman Gashi, auditor i brendshëm: Unë, do të ndalem në çështjet kryesore! E para, ajo që po ngritet prej jush dhe që është e paqartë, unë e kam detyrë audituese. Brenda një jave, raporti do të jetë i gatshëm: prej specifikave të njërive kërkuese, krahasimeve dhe deri te menaxhimi i kontratave, tejkalimet, dështimet, ndërprerjet e kontratave për shkak të furnizimeve jo cilësore etj. Në anën tjetër, kur është fjala për tejkalimet e kontratave, tejkalime ka ! Mirëpo, nuk ka tejkalime të sasive të kërkuara me plan të buxhetit nuk ka! Kërkesat, janë ato që janë planifikuar me buxhet, dhe me plan të prokurimit. Problemet janë shfaqur te kontraktimet e tyre. Sepse, kontrata është mbyllur vetëm me porosinë për Raundin e Parë të Zgjedhjeve dhe pastaj, Raundi i Dytë ka mbetur pa mundësi kontraktimi !

Në vazhdim, z. Gashi, shpjegoi faktin se si janë bërë këto procedura, pse lëndët po shkojnë në prapësim...!

Në këtë pikë, diskutuan dhe analizuan çështjen e raportit sërish, znj. Valdete Daka, Adnan Rrustemi, Sylejman Gashi – auditor i brendshëm i cili, shpjegoi në detale aspektet e procedurave se si ka ardhur deri te tejkalimet, cilat janë obligimet, pse lëndët shkojnë në prapësim etj.

Valdete Daka: Ne i kemi pasur zgjedhjet Lokale, por një gjë nuk jam duke e kuptuar: cila njësi nuk ka bërë planifikime për dy raunde? Ata janë fajtor...! Kjo barrë ka me i ra KQZ. Ne si institucion, kemi me raportua edhe para Kuvendit. Kurse, ne kemi me i paguar 400 000 euro ekstra të cilat, s'i kemi! Kush ka me i pagua...? Këtë shpjegojeni profesionalisht? Ne, këto mjete si kemi planifikua...!

Ne, tha znj. Daka, nuk kemi bërë zgjedhje për herë të parë...Si ka mundur me ndodh kështu...? Dikush, duhet të përgjigjet...!

Sylejman Gashi: unë, i kam të detajuar kush çka ka kërkuar, ndërsa çështja është e dhimbshme...!

Valdete Daka: Sekretariati, ka me u vu në pikëpyetje. Pagat dhe mëditjet nuk preken, por planifikimet e tjera, të gjitha... Pastaj, tha znj. Daka, janë edhe rekomandimet e auditorit gjeneral që nuk janë përmbushë...Unë, duhet të shkoj në Komision Parlamentar, dhe unë përgjigjem. E këtu, askush nuk po përgjigjet. Qe për shembull, rekomandimi “4” nuk është implementuar, rekomandimi “5” pjesërisht është implementuar, rekomandimi “8” po ashtu, rekomandimi “10” nuk është implementuar, “12” i pa implementuar... Pra, pse nuk janë implementuar...Unë, s'i kam me i arsyetuar mos plotësimet e rekomandimeve...

Shpenzimet telefonike 66 000 euro...! Definitivisht, kjo duhet të ndërpritet. Pastaj, qira 55 000 euro... Çka është kjo...? S'kemi si me i arsyetua...! Riparimi i veturave, 11 000 euro, dreka zyrtare...

Edhe një pyetje e kam: “Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit: 26 000 euro...!?” Brenda vendit...? Fq. 10.

Adnan Rrustemi: Qysh ka mundësi kjo...?

Miradije Meha: Këtu, hyjnë delegacionet që kanë ardhur, shpenzimet e atyre që kanë shkuar me e përcjellë shtypjen e “Listës votuese” në “Dukagjin”...

Valdete Daka: Akomodime zyrtare brenda vendit: 7000 euro...! Çka janë more këto...? Furnizim për zyre: 1 milion e 80 4000 euro...? Furnizim me ushqim e pije: 4 700 veç drekave zyrtare, derivate për vetura: 18 000 euro...Riparimi i ndërtesave: 37 000 euro...?! Çka kemi riparuar, cilat ndërtesa...?

Miradije Meha: Janë shpenzime për dy palë zgjedhje...

Eshref Vishi: A e kalojmë raportin, sepse jemi të detyruar...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin vjetor financiar për vitin 2017

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimeve për vitin 2017

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ miratuan edhe raportin e buxhetit të shpenzimeve për vitin 2017.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i ueb faqes së re të KQZ-së

Kreshik Spahiu, drejtor i IT-së: E kemi hartuar dokumentin për rifreskimin e Ueb faqes që ka qenë në plan të punës në bashkëpunim me IFES-in dhe OSBE-në, dhe ne kemi punuar vazhdimisht në këtë drejtim. Që prej 2 shtatorit 2017, ka filluar punën një grup i Sekretariati në bashkëpunim me IFESI-in, dhe sapo është bërë dizajnimi i faqes, grupi është zgjeruar edhe me anëtarë të KQZ-së.

Në vazhdim, z. Spahiu, shpjegoi në përgjithësi, informacionet, funksionet, shërbimet, produktet, linqet dhe mënyrën e specifikave që përmban ueb faqja. Anëtarët e KQZ-së, në kontekst, dhanë vlerësimet e tyre, sugjerimet, mënyrën e mirëmbajtjes etj. Mirëmbajtjen e ueb faqes, e kemi futur në plan të punës. Jemi në përpilim të një drafti, ku secili do ta ketë përgjegjësinë në raport me ueb faqes...

Valdete Daka: Për nesër, lidhur me ditën Globale të Zgjedhjeve çka do të kemi...?

Kreshnik Spahiu: Unë, do ta bëjë një prezantim të saj... Kurse, kërkohet një miratim formal i juaji sepse, të dielën ueb faqen e kemi lansuar edhe zyrtarisht në domenin e KQZ-së.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
